



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1277/1 prot.

Tiranë më 13.08.2018

Lënda: Mendim mbi një memorandum bashkëpunimi.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.3949/2 Prot., datë 09.08.2018, në lidhje me "Memorandumin operacional kundër drogës ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Qendrore për Shërbimet e Antidrogës në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Italisë", Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi dokumenti është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Përpunimi dhe transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale në kuadër të këtij memorandum, legjitimohet në bazë të pikave 1 dhe 2 të nenit 6, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Sugjerojmë që në vijim të pikës 9 të shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:
"Palët angazhohen që të marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që do të përpunohen në kuadër të këtij memorandum, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale në vendet respektive".

Nisur nga praktika e ndjekur në raste të marrëveshjeve të ngjashme vlerësojmë si të nevojshme që të përcaktohet se çfarë do të ndodhë me të dhënat personale të shkëmbyera në kuadër të këtij memorandum, në rast të pezullimit ose ndërprerjes së tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

